



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONTRATA

02 / 10 / 2019

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: “Albo group” Shpk OJQ “Eko Vizion” adresa: Prishtinë me numere te regjistrimit te biznesit dhe numër fiskal 811331066 përfaqesuar nga Albonë Rruku drejtor, (në vazhdim “Operatori Ekonomik”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Fushata vetëdijesuese per shfrytëzimin e transportit publik me numër Identifikues 616-19-123-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Fushata vetëdijesuese per shfrytëzimin e transportit publik**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me *nga dita e caktuar ne planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit dhe përfundon ne afatin prej 180 ditëve.*

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë ne Prishtine sipas kërkesave te zyrtareve te Autoritetit Kontraktues

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,948.00 €; (Katër mije e nëntëqind e katër dhjete e tetë Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës në dy situacione. Situacioni i I-re paguhet pas përfundimit të shërbimeve në vlerën prej 2,500.00 euro apo edhe më tepër pas pranimit të kryerjes së shërbimeve me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit, ndërsa situacioni i dytë paguhet pas përfundimit të kryerjes së shërbimeve me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni nuk aplikohet.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res-judicata për mashtrim,

korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore





13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri dhe mbiemri:	Zekë Bardhaj	Emri dhe mbiemri:	Albonë Rruku
Pozita:	Udhëheqës i prokurimit	Pozita:	Wrejtore e...
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	02.10.2019	Data:	04.10.2019
Vula:		Vula:	

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Detyra projektuese për përgatitjen e “Fushatën vetëdijësuese për shfrytëzimin e transportit publik”

Qëllimi: Ngrija e vetëdijes së qytetarëve për shfrytëzimin e transportit publik si dhe rritja e shfrytëzimit të këtij transporti.

Mbështetja e praktikave të mira të shfrytëzimit të transportit publik duke i angazhuar të rinjtë në promovimin e transportit publik dhe reduktimin e përdorimit të veturave personale.

Fokus grupi kryesor në kuadër të projektit do të jenë të gjithë qytetarët e komunës së Prishtinës duke përfshirë grupmoshat e ndryshme, të të dy gjinive.

Fushata duhet të vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore, ekonomike, senzibilizuese të këtij plani, po ashtu duhet të rekomandojë ndryshimet e nevojshme në shfrytëzimin e transportit publik.

Këto aktivitete duhet bërë së bashku me ekipet e Komunës, me shoqëri civile, grupet e interesit duke përfshirë të gjitha fazat si dhe duhet organizuar aktivitetet e nevojshme.

Detyrë e OE është që të konsultohet me legjislacionin në fuqi, me udhëzimet administrative në lidhje me fushatat vetëdijësuese, me institucionet përgjegjëse që të mos bëjë shkelje apo pengesa në institucionet e tjera.

Për të arritur rezultatet dhe qëllimet është e nevojshme bashkëpunimi me kolegët duke kërkuar të dhëna, duke pranuar ide te reja nga personat me kompetencë.

Koncepti i Fushatës vetëdijësuese për shfrytëzimin e transportit publik

Ju duhet të sqaroni kuptimin e juaj të objektivave të angazhimit, qasjen e shërbimeve, metodologjinë për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve të pritura, dhe shkallën dhe detajet e rezultatit të tillë. Ju duhet të theksoni problemet që janë duke u ballafaquar dhe rëndësinë e tyre, dhe të sqaroni qasjen teknike që do të adoptoni për tu ballafaquar me ato. Ju gjithashtu duhet të sqaroni metodologjitë që ju propozoni të miratoni dhe theksoni përshtatshmërinë e metodologjive të tilla me qasjen e propozuar.

Metodologjia e punës:

Përcaktimi dhe përshkrimi i hapave kyç të cilat propozohen të ndërmerren gjatë procesit të realizimit të **Fushatës vetëdijësuese për shfrytëzimin e transportit publik**, duke ndikuar në rritjen e numrit të udhëtarëve në shfrytëzimin e transportit publik.

Metodologjia e punës duhet të përshkruaj edhe burimet e të dhënave të cilat do të shfrytëzohen gjatë zbatimit të fushatës vetëdijësuese së shfrytëzimit të transportit publik.

Metodologjia e përfshirjes së pjesëmarrësve: duhet të përshkruhen aktivitetet promovuese të transportit publik edhe metodologjinë e përfshirjes së qytetarëve dhe akterëve tjerë, përshkrimi në identifikimin, kategorizimin e pjesëmarrësve, mënyrën e njoftimit, informimit, takimeve dhe përfshirjes së qytetarëve dhe akterëve tjerë në çdo aktivitet të fushatës. OE duhet të përshkruaj se si informata e tyre do të arrijë te qytetarët, se si do të i anagzhojnë më shumë qytetarë në aktivitetet e tyre.

Orari i aktiviteteve

Të përshkruhet orari i aktiviteteve për të gjithë Fushatën vetëdijësuese për shfrytëzimin e transportit publik. Aktivitetet duhet të përfundojnë më së largu deri me 5 dhjetor 2019.

Prokurimi: 616-19-6894-2-3-6

Nr i brendshëm: 616 19 123 236

Tituli: Fushata vetëdijesuese per shfrytezimin e transportit publik

1 Fushata vetëdijesuese per shfrytezimin e transportit publik

Kodi i tenderit: 616-19-6894-2-3-6

Data: 17.09.2019

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1. Certifikata_e_regjistrimit_Albo_group.pdf
2.	2. Dokumentet_Ekovizioni_30042019.pdf
3.	3. Deklaratat e partneritetit.pdf
4.	4. DnB.pdf
5.	5. Lista e projekteve Ekovizioni.pdf
6.	6. Metodologjia.pdf
7.	7. Lista e stafit.pdf
8.	8. Formulari C.pdf
9.	9. Pershkrimi i cmimit.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Fushata vetëdijesuese per shfrytezimin e transportit publik	9. Pershkrimi i cmimit.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

jo

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 616-19-6894-2-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik Albo Group SH.P.K.; EV, Rr. "Hyzri Talla", 10000, Prishtinë, Kosovë**

E-mail: **albogroup19@gmail.com**

Personi kontaktues: **Albonë Rruku**

Telefoni: **044/469686**

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **Albo Group SH.P.K.**

Numri fiskal: **811331066**

Vend-Selia: **Rr. "Hyzri Talla", 10000, Prishtinë, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **"EV"**

Numri fiskal: **600346713**

Vend-Selia: **Rr. "Zahir Pajaziti" p.n., 11000, PODUJEVË, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-19-6894-2-3-6

Titulli i kontratës: Fushata vetëdijesuese për shfrytëzimin e transportit publik

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Fushata vetëdijesuese për shfrytëzimin e transportit publik

3. Çmimi total i tenderit është:

4.948,00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj


nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit	Përshkrimi	Njësia/Sasia	Çmimi total €
1.	Fushata vetëdijesuese për shfrytëzimin e transportit publik sipas specifikimit teknik të detyrueshëm - Aneksi I	Paushefi	4948.00
			4948.00 €

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	"Albo Group" shpk
ADRESA E PLOTE	Rr. "Hyzri Talla" nr. 16, Prishtinë
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	Albonë Rruku
POZITA	Drejtor i shërbimit
NENSHKRIMI	
DATA	13.09.2019
VULA	